



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

01 Nr. UA-152-709/09
Prishtinë, me 16/06/2009

Në Bazë të Nenit 93 pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, neni 1, pika 1.3 (d), siç është plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. 2005/53 – Shtojca XV pika (V) dhe të nenit 6 të Ligjit për noterinë Nr. 3/L-010, Ministria e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR PROGRAMIN DHE MËNYRËN E DHËNIES
SË PROVIMIT TË NOTERISË**

Fushëveprimi

Neni 1

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet programi i provimit të noterisë, themelimi dhe puna e Komisionit për dhënie e provimit të noterisë, përmbajtja e procesverbalit për rrjedhën e punës së Komisionit gjatë pyetjes së kandidatëve për noter, lëshimi i certifikatës për dhënie e provimit të noterisë, mënyra e mbajtjes së evidencës për personat të cilët e kanë paraqitur, e kanë dhënë provimin e noterisë si dhe të drejtat e kandidatit për ankim përkitazi me punën e Komisionit.

Përkufizimet

Neni 2

Për qëllim të këtij Udhëzimi Administrativ, termet e mëposhtme kanë këto domethënie:

- 1 “Komision” nënkupton Komisionin për pyetjen e kandidatëve për provimin e noterisë,
- 2 “Komisioni special” nënkupton komisionin ad hoc për të emëruar nga Ministri i Drejtësisë, në bashkëpunim me USAIDI-in dhe SDC-en Zvicerane, për testimin e të gjithë kandidatëve të paraqitur për trajnim,
- 3 “Program” nënkupton programin për dhënie e provimit të noterisë,
- 4 “Ministria” nënkupton Ministrinë e Drejtësisë,
- 5 “Ministër” nënkupton Ministrin e Ministrisë së Drejtësisë,
- 6 “Provim “ nënkupton Provimin e noterisë.

Lëndët e provimit

Neni 3

Programi i provimit të noterisë përmban lëndët e parapara me nenin 7 të Ligjit të noterisë, materien, burimet juridike dhe literaturën për secilën lëndë.

Kushtet për paraqitje të provimit të noterit

Neni 4

1. Çdo person i cili i plotëson kushtet për ushtrimin e profesionit të noterit nga neni 4 i ligjit të Noterisë, mund të parashtrijë kërkesën për të iu nënshtruar provimit të noterisë, në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës.
2. Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë publikon njoftimin me shkrim në mjetet e informimit, në të dy gjuhët zyrtare, në mënyrë që t'i mbledh kërkesat e kandidatëve të interesuar për dhënie të provimit të noterit.
3. Pas marrjes së kërkesave të kandidatëve, Ministria i shqyrton të gjitha kërkesat e parashtruara për të vërtetuar nëse kandidatët e paraqitur i plotësojnë kushtet për t'u nënshtruar provimit për noter dhe pas shqyrtimit të kërkesave të parashtruara për secilin kandidat lëshohet vendimi me shkrim në bazë të cilit kandidatit i lejohej apo nuk i lejohej dalja para Komisionit pyetës për dhënie të provimit të noterisë, secili kandidat veç e veç informohet me shkrim me përmbajtjen e vendimit, në kohën e duhur.

Kushtet për nënshtrim të provimit të noterit

Neni 5

1. Për fazën e periudhës kalimtare, provimit të noterit mund t'i nënshtrohen kandidatët të cilët kanë përvojë pune 4 vite në lëmin juridike.
2. Pas kalimit të periudhës kalimtare, provimit të noterit mund t'i nënshtrohen dhe kandidatët të cilët, bazuar në nenin 5 pika 4 e Ligjit për noterinë, kanë punuar 3 vite si ndihmës në zyrën e noterit.

Vijimi i kursit trajnues

Neni 6

1. Ministria e Drejtësisë, si organ kompetent për organizimin e provimit të noterisë, organizon trajnimin e parë për kandidatët të cilët dëshirojnë t'i nënshtrohen dhënies së provimit të noterisë.
2. Trajnimi organizohet për 200 kandidatë. Po që së për trajnim paraqitën më shumë se 200 kandidatë, atëherë Komisioni special i emëruar nga Ministria e Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim me USAIDI-in dhe SDC-en Zvicerane, do të organizojë testimin e të gjithë kandidatëve, në atë rast prej të gjithë kandidatëve të paraqitur do të përzgjidhen kandidatët më të mirë, e cila përzgjedhje bazohet në rezultatet e testit dhe në strukturën komunale (prej cilës komunë janë kandidatët).
3. Kusht për t'u nënshtruar provimit të noterisë është vijimi i trajnimit, i cili do të mbahet në përdhën 10 mujore, nga 4 ditë në muaj.

4. Kandidati i cili nuk merr pjesë në më shumë se tri sesione të trajnimit, humbë të drejtën për t'iu nënshtruar provimit të noterisë.

Provimi i noterisë

Neni 7

Provimi noterisë jepet me shkrim dhe me gojë. Përmbajtja e provimit me shkrim dhe me gojë duhet të jetë në përputhshmëri me programin e kursit trajnues për përgatitjen e kandidatëve për provim të noterisë.

Lënda e pjesës së provimit me shkrim

Neni 8

1. Provimi me shkrim përbëhet nga tri detyra të cilat punohen duhet të zgjidhen brenda 4 orëve. Me anë të detyrave me shkrim kandidatët provohen nëse janë në gjendje të përpilojnë shkresa (dokumente) noteriale nga këto lëmi:
 - E drejta e detyrimeve dhe e drejta pronësore ,
 - E drejta familjare dhe e drejta trashëgimore ;
 - E drejta ekonomike ;
 - E drejta e procedurës civile ;
2. Detyrën me shkrim dhe lëmin nga e cila do punohet detyra me shkrim e cakton Komisioni në përbërje të plotë

Lëndët në pjesën e provimit me gojë

Neni 9

1. Provimi me gojë mbahet brenda një dite të cilën e cakton kryetari i Komisionit, nga lëndët :
 - E drejta e detyrimeve dhe e drejta pronësore ,
 - E drejta familjare dhe e drejta trashëgimore ;
 - E drejta ekonomike ;
 - E drejta e procedurës civile ;
 - Shërbimi i noterisë dhe
 - Shërbimi për kadastrën.

Komisioni i provimit për noter

Neni 10

1. Provimi i noterisë jepet para Komisionit provues të cilin e formon Ministri i Drejtësisë. Komisioni përbëhet nga kryetari dhe 6 anëtarët e komisionit.
2. Komisioni emërohet nga radhët e juristëve të diplomuar të cilët e kanë të dhënë provimin e jurisprudencës dhe të cilët janë dëshmuar me punën e vetë si ekspertë të drejtësisë dhe nga radhët e profesorëve të Fakultetit juridik, të cilët me punën e tyre në shkencë dhe në organet e jurisprudencës janë dëshmuar si ekspert të dalluar .

3. Në periudhën kalimtare në Komision provues mund të emërohet edhe anëtari i odës së noterisë nga ndonjë shtet fqinjë.
4. Pas periudhës kalimtare, komisioni provues do të përbëhet nga 4 noter, 1 gjyqtar, 1 profesor i drejtësisë dhe 1 avokat i Odës së Avokatëve të cilin e cakton Oda. Mandati i tyre është 3 vjet, me mundësi që pas skadimit të mandatit, gjysma e anëtarëve të rizgjedhën edhe për një mandat.
5. Kryetarit të Komisionit dhe anëtarëve u caktohen zëvendësit e tyre.

Emërimi i komisionit provues

Neni 11

1. Me vendim për emërimin e Komisionit caktohet se cilat lëndë do të pyet kryetari i Komisionit e cilat anëtarët e Komisionit, përkatësisht zëvendësit e tyre.
2. Me të njëjtin vendim emërohet dhe sekretari i Komisionit nga radhët e zyrtarëve të Ministrisë së Drejtësisë.
3. Anëtarëve të Komisionit dhe sekretarit për punë në Komision u takon kompensimi, lartësinë e të cilit e cakton Ministri i Drejtësisë.

Plani dhe afatet për dhënien e provimit të noterisë

Neni 12

Planin dhe terminin për nënshtrimin në pjesën e provimit me shkrim dhe me gojë të noterisë e cakton kryetari i Komisionit.

Njoftimi për afatin e dhënies së provimit

Neni 13

Kandidatit të cilit i është lejuar nënshtrimi në provim të noterisë duhet që të informohet 30 ditë para datës se caktuar për mbajtjen e pjesës së provimit me shkrim. Me kërkesën kandidatit ky afat mund të jetë edhe me shkurt.

Procedura në pjesën e provimit me shkrim

Neni 14

1. Në fillim të pjesës me shkrim të provimit anëtari pyetës i Komisionit pyet lëndën e cila jepet me shkrim. Sekretari i Komisionit konstaton identitetin e kandidatëve, pastaj kandidatëve u dorëzohet detyra dhe njoftohen me dispozitat e ligjore në fuqi, të cilat duhet t'i respektojnë gjatë kohës së zgjedhjes me shkrim të detyrës.
2. Provimi me shkrim punohet në letër të pajisur me kod, për shkak të ruajtjes së anonimitetit. Kodin e cakton Ministria, i cili zbulohet para shpalljes së rezultateve të provimit me shkrim.

3. Gjatë kohës së provimit me shkrim kandidatit nuk i lejohet të kontaktojë me persona tjerë, ta përdorë telefonin mobil dhe ta braktisë hapësirën në të cilin mbahet provimi me shkrim, me përjashtim të rasteve të arsyeshme.
4. Me rastin e hartimit të detyrës me shkrim, kandidati mund të shërbehet vetëm me tekstet e dispozitave ligjore, pa komente .
5. Nëse ndonjëri nga kandidatët gjatë provimit me shkrim shërbehet me ndonjë mjet të pa lejueshëm, do të përjashtohet nga provimi me shkrim dhe do të konsiderohet së nuk e ka dhënë provimin.

Kohëzgjatja e provimit me shkrim

Neni 15

1. Koha për hartimin e detyrës me shkrim zgjatë 4 orë, prej kohës së dorëzimit të detyrës.
2. Kandidati detyrohet ta dorëzojë detyrën dhe punimin me shkrim brenda kohës së parashikuar për hartimin e saj. Nëse brenda kësaj kohe kandidati nuk e dorëzon detyrën dhe punimin ose gjatë kohës së provimit heq dorë nga hartimi i detyrës, konsiderohet se **nuk e ka dhënë provimin**.
3. Koha e dorëzimit të punimit me shkrim do të shënohet në kopertinën e punimit.
4. Kandidati i cili e dorëzon punimin me shkrim detyrohet që ta lëshojë hapësirën ku mbahet provimi.

Vlerësimi i provimit me shkrim

Neni 16

1. Pas kontrollimit të punimeve me shkrim nga ana e anëtarëve të Komisionit, të cilët pyesin lëndën nga e cila jepet pjesa me shkrim e provimit, Ministria e cakton vendin dhe kohën e mbajtjes së takimit të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e punimeve me shkrim.
2. Vendimin për vlerësimin e suksesit të arritur në punimin me shkrim e miraton Komisioni, me shumicë votash, pas marrjes së mendimit nga anëtarët e Komisionit të cilët i kanë kontrolluar punimet me shkrim.
3. Punimi me shkrim vlerësohet me **“kalon”** ose **“nuk kalon”**.

Shpallja e rezultateve të provimit me shkrim

Neni 17

1. Pas përfundimit të pjesës së provimit me shkrim, Ministria në bashkëpunim me kryetarin e Komisionit cakton vendin dhe kohën e mbajtjes së provimit me gojë.
2. Para se të fillojë provimi me gojë, kryetari i Komisionit në përbërje të plotë të Komisionit, kandidatëve ua komunikon rezultatin e pjesës së provimit me shkrim.

Kushti për nënshtrim të provimit me gojë

Neni 18

1. Kandidatët të cilët nuk **kanë kaluar pjesën me shkrim prej dy detyrave**, do të konsiderohet së **nuk e kanë kaluar provimin** dhe atyre nuk u lejohet nënshtrimi në provim me gojë.
2. Kandidati i cili i nënshtrohet pjesës me gojë të provimit por që nuk e ka dhënë pjesën me shkrim nga njëra prej detyrave, nuk mund t'i nënshtrohet pjesës së provimit me gojë në lëmin që nuk e ka kaluar pjesën me shkrim të provimit.

Provimi me gojë

Neni 19

1. Kandidatit të cilit i vlerësohen dy nga detyrat me shkrim me **“kalon”**, i nënshtrohet i pjesës me gojë të provimit.
2. Kandidati i cili i nënshtrohet pjesës me gojë të provimit, e të cilit njëra nga detyrat i vlerësohet me **“nuk kalon”**, nuk mund t'i nënshtrohet pjesës së provimit me gojë në lëmin që nuk e ka kaluar pjesën me shkrim të provimit.

Rrjedha e provimit me gojë

Neni 20

1. Nëse kandidati në pjesën e provimit me gojë heqë dorë nga provimi ose nuk paraqitet në provim në afatin e caktuar, konsiderohet se **nuk e ka dhënë provimin**.
2. Pas komunikimit të rezultatit të punimeve me shkrim, kandidatët pyeten me gojë nga lëndët e caktuara sipas radhës që e cakton kryetari i Komisionit. Provimi me gojë është publik dhe mbahet para Komisionit provues në përbërje të plotë.
3. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit, gjatë provimit, kandidatit mund t'i shtrojnë pyetje edhe nga lëndët ku nuk janë pyetës.
4. Anëtari i Komisionit i cili pyet lëndën nga e cila jepet pjesa me shkrim e provimit, para se ta fillojë provimin me gojë, mund të kërkojë nga kandidati që shkurtimisht t'i shpjegojë zgjidhjet e veta, t'i arsyetojë ose ta sqarojë shtjellimin e detyrës.
5. Me qëllim të sigurimit të rendit, Komisioni mund të kufizojë numrin e personave të cilët dëshirojnë të jenë prezent gjatë provimit publik.

Suksesi përfundimtar

Neni 21

1. Pas përfundimit të provimit me gojë, Komisioni në përbërje të plotë, me shumicë votash, nxjerr vendimin për suksesin e kandidatëve. Suksesin e kandidatit Komisioni e vlerëson sipas rezultatit që ka treguar ai në pjesën me shkrim dhe me gojë të provimit dhe vlerësohet me **“ka kaluar”**, ose **“nuk ka kaluar”**.

2. Kandidati i cili tregon nivel të lartë të diturisë në provim me shkrim dhe me gojë nga të gjitha lëndët vlerësohet me **“ka dhënë provimin me sukses të dalluar”**.
3. Rezultatit e suksesit në provim e kumton publikisht kryetari i Komisionit.
4. Pas përfundimit të provimit me gojë, Komisioni ia dërgon raportin Ministrit.

Mbetja e kandidatit në riprovim

Neni 22

1. Nëse Komisioni pyetës vlerëson se kandidati nuk ka treguar sukses të kënaqshëm në **një lëndë, do të vendos që sërish të pyetet (riprovohet) nga e njëjta lëndë.**
2. Afati për paraqitjen e riprovimit nuk mund të jetë më i shkurtër se 1 e as më i gjatë se 4 muaj nga data kur kandidati ka mbetur në riprovim.
3. Nëse kandidati nuk paraqitet në kohën e caktuar për riprovim ose nuk tregon sukses të kënaqshëm në riprovim, konsiderohet se **nuk e ka dhënë provimin.**
4. Kandidatët që mbesin në riprovim nga lënda që jepet edhe me shkrim, e të cilët më parë e kanë kaluar pjesën me shkrim të provimit, me rastin e riprovimit nuk do t'i nënshtrohen sërish pjesës me shkrim të provimit.

Shtyrja e provimit të filluar të noterisë

Neni 23

1. Provimi i filluar mund të shtyhet nëse kandidati sëmuret, përjeton ndonjë aksident, ka rast vdekje në familje ose për ndonjë arsye të ngjashme, për shkak të cilës nuk mund ta vazhdojë provimin.
2. Për shtyrjen e provimit të filluar, vendos kryetari i Komisionit në bashkërendim me anëtarët e Komisionit, duke u bazuar në dëshmitë që do t'i prezantojë kandidati.
3. Afati brenda të cilit kandidati duhet të parashtrojë kërkesë për provimin më parë të shtyrë nuk mund të jetë më i gjatë se 2 muaj nga data e shtyrjes së provimit.
4. Nëse kandidati nuk paraqitet në kohën e caktuar për ta vazhduar provimin e shtyrë, konsiderohet se **nuk e ka dhënë provimin.**

Nënshtrimi i sërishëm i kandidatit në riprovim

Neni 24

1. Kandidati i cili nuk e ka dhënë provimin, mund ta përsëris kërkesën për provim brenda afatit i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 4 muaj.
2. Kandidati i cili nuk kalon provimin për të dytën herë, mund ta përsëris kërkesën për provim brenda afatit i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 12 muaj.

Mbrojtja e të drejtave të kandidatit

Neni 25

1. Kandidati i cili konsideron se sukcesi i tij i përgjithshëm ose sukcesi nga njëra lëndë nuk i është vlerësuar drejt, ka të drejtë t'i parashtrijë ankesë Komisionit brenda tri ditëve të punës nga dita e komunikimit të rezultateve.
2. Komisioni është i detyruar që brenda afatit prej pesë ditëve të punës ta shqyrtojë ankesën e parashtruar, për çka duhet ta njoftojë kandidatin.
3. Nëse ankesa e kandidatit aprovohet, Komisioni duhet ta përsëris provimin.

Procesverbali

Neni 26

1. Gjatë provimit mbahet procesverbali i veçantë dhe procesverbali shtojcë për provim me shkrim për çdo kandidat.
2. Në procesverbal shënohen:
 - nr. i procesverbalit (nr. i lëndës) dhe data,
 - emri dhe mbiemri i kandidatit,
 - Institucioni, organizata ku punon kandidati,
 - numri dhe data e aktvendimit për lejimin e nënshtrimit në provim,
 - sa herë kandidati i është nënshtruar provimit,
 - data dhe ora e mbajtjes së pjesës me shkrim dhe me gojë të provimit,
 - detyrat për pjesën me shkrim që i janë shtruar kandidatit,
 - konstatimi i Komisionit për epilogun e provimit me shkrim për kandidatin dhe vërejtjet përkitazi me punimin e shtjelluar,
 - pyetjet që i janë shtruar kandidatit në pjesën e provimit me shkrim dhe me gojë,
 - vendimi i Komisionit lidhur me rezultatin e tërësishëm të provimit me shkrim dhe me gojë,
 - vërejtjet që janë me rëndësi për rezultatin e provimit me gojë dhe me shkrim,
 - nënshkrimet e kryetarit, anëtarëve dhe të sekretarit të Komisionit,Procesverbalit i bashkëngjiten detyrat e shtjelluara me shkrim të kandidatit.

Evidenca -baza e të dhënave

Neni 27

1. Ministria mban me shkrim dhe në formë elektronike evidencën - bazën e të dhënave për kandidatët që kanë paraqitur provimin dhe për kandidatët që kanë dhënë provimin.
2. Kjo evidencë mbahet në librin që mund të shfrytëzohet për një apo më shumë vite kalendarike.
3. Evidenca mbahet posaçërisht për secilin vit kalendarik dhe mbyllet në ditën e fundit të punës së vitit përkatës. Në fund të viti kalendarik, evidencën e vërteton Ministri i Drejtësisë.
4. Evidenca përmban të dhëna për kandidatin si në vijim:
 - numrin e lëndës dhe datën e regjistrimit,

- emrin dhe mbiemrin dhe vendin prej nga është kandidati,
- datëlindjen dhe vendlindjen e kandidatit,
- emërtimin e universitetit dhe datën e diplomimit,
- datën e dhënies së provimit dhe suksesin e arritur në provim dhe vërejtjet.

Certifikata për provimin e dhënë të noterisë

Neni 28

1. Ministria brenda afatit prej 3 muajsh nga dita e dhënies së provimit lëshon certifikatën për provimin e dhënë.
2. Certifikatën për provimin e dhënë të noterisë e nënshkruan Ministri.
3. Me kërkesë të kandidatit pas përfundimit të provimit mund të lëshohet vërtetimi i përkohshëm për dhënien e provimit të cilin e nënshkruan sekretari i Komisionit.
4. Certifikata përmban:
 - Logon e organit i cili lëshon certifikatën,
 - numrin dhe datën e lëshimit të certifikatës,
 - emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e kandidatit,
 - datëlindjen, vendin e lindjes dhe komunën e lindjes,
 - emërtimin e universitetit dhe datën e diplomimit,
 - datën e dhënies së provimit dhe suksesin,
 - emrin e Komisionit para të cilit kandidati ka dhënë provimin,
 - bazën juridike për lëshimin e certifikatës,
 - nënshkrimin e Ministrit dhe
 - vulën zyrtare.

Lëshimi i certifikatës së humbur-dublikata

Neni 29

1. Personit i cili ka humbur certifikatën për dhënien e provimit mund të kërkojë nga Ministria që t'i lëshohet dublikata e certifikatës së humbur.
2. Personi i cili kërkon lëshimin e dublikatës së certifikatës, kërkesës duhet t'ia bashkangjes:
 - vërtetimin që ka shpallur të pa vlefshme certifikatën e humbur dhe
 - fletëpagesën e bërë në bankë në shumë prej 10€ në llogari të Thesarit të Kosovës.

Programi i provimit të noterisë

Neni 30

Programi për dhënien e provimit është si vijon:

E DREJTA E DETYRIMEVE DHE E DREJTA PRONËSORE

I. Parimet e marrëdhënieve të detyrimeve:

Marrëdhëniet e detyrimeve;

1. Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve;
2. Autonomia e vullnetit;
3. Ndërgjegjshmëria dhe ndershmëria;
4. Detyra e përmbushjes së detyrimit (pacta sun servanta);
5. Kujdesi i duhur në përmbushjen e marrëdhënieve të detyrimeve;
6. Ndalimi i keqpërdorimit të së drejtës;
7. Ndalimi i shkaktimit të dëmit konsumatorit.

II. Krijimi i detyrimeve:

1. Kontrata;
2. Nocioni i kontratës;
3. Kushtet e përgjithshme të lidhjes së kontratës;
4. Aftësia për të kontraktuar. Pajtimi i vullnetit;
5. Kontratat e negociuara jashtë lokaleve afariste;
6. Kontratat distancore;
7. Kushtet e përgjithshme të kontratave formularë - Objekti i kontratës.
8. Të metat e vullnetit;
9. Forma e kontratës;
10. Avansi dhe Pendesa. Përfaqësimi;
11. Llojet e përfaqësimit;
12. Interpretimi i kontratës;
13. Pavlefshmëria e kontratës;
14. Kontratat nule dhe kontratat e rrëxueshme (nuliteti absolut dhe relativ);
15. Pavlefshmëria e kushteve të përgjithshme të kontratave;
16. Kontratat e dyanshme detyruese;
17. Përgjegjësia për të metat materiale të përmbushjes së detyrimit;
18. Përgjegjësia për të metat juridike (evikcioni) të përmbushjes së pretimeve kontraktuese;
19. Kundërshtimi i mospërmbushjes së kontratës;
20. Zgjidhja e kontratës për shkak të mospërmbushjes;
21. E drejta e revokimit dhe e kthimit te kontratat konsumuese;
22. Zgjidhja e kontratës për shkak të rrethanave të ndryshuara (Clausula Rebus Sic Stantibus).
23. Pamundësia e përmbushjes;
24. Kontrata në dobi të personit të tretë.

III. Shkaktimi i dëmit:

1. Nocioni;
2. Bazat e përgjegjësisë;
3. Përgjegjësia në bazë të fajësisë;

4. Përgjegjësia objektive;
5. Përgjegjësia për tjetrin;
6. Përgjegjësia e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm ose nga veprimtaria e rrezikshme;
7. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët. Përgjegjësia e shkaktuar nga ndërtime. Përgjegjësia për automjetet motorike;
8. Përgjegjësia nga të metat e produkteve;
9. Përgjegjësia për reklamë mashtruese;
10. Rastet e veçanta të përgjegjësive: për shkak të akteve terroriste; për shkak të refuzimit të dhënies së ndihmës së domosdoshme, për shkak të cenimit të detyrimit të lidhjes së kontratës;
11. Kompensimi i dëmit material;
12. Vëllimi i shpërblimit të dëmit;
13. Kompensimi i dëmit material në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe shkatërrimit të shëndetit;
14. Kompensimi i dëmit jo material;
15. Format e s Kompensimi jo material;
16. Përgjegjësia e dëmit të shkaktuar nga disa persona.

IV. Pasurimi pa bazë:

V. Gjëruesi i punëve të huaja pa autorizim:

1. Nocioni;
2. Detyrimet dhe të drejtat e drejtuesit të punëve;
3. Kryerja e punëve të huaja kundër ndalesës, kryerja e padrejtë e punëve;
4. Lejimi i punëve të kryera pa autorizim.

V. Shprehja e njëanshme e vullnetit

VI. Letrat me vlerë:

1. Nocioni;
2. Realizimi i të drejtës nga letrat me vlerë;
3. Bartja e të drejtës nga letrat me vlerë;
4. Ndryshimet nga letrat me vlerë;
5. Përmbushja e detyrimit nga letrat me vlerë;
6. Letrat legjitimuese dhe shenjat.

VII. Efektet e detyrimeve:

1. Te drejtat e kreditorit dhe detyrimet e debitorit;
2. Dënimi kontraktues. Kamatëvonesa;
3. Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit;

VIII. Shuarja e detyrimeve:

1. Përmbushja - kush mund ta bëjë përmbushjen, kujt mund t'i behët përmbushja;
2. Përmbushja me subrogim – kujt i bëhet përmbushja, lënda e përmbushjes, llogaritja e përmbushjes, koha e përmbushjes, vendi i përmbushjes;
3. Vonesa e debitorit, vonesa e kreditorit;
4. Depozitimi dhe shitja e sendeve që janë objekt i borxhit;
5. Kompensimi, falja e borxhit, përtëritja (novacioni), konfondimi (konfusio), kalimi i kohës dhe denoncimi, vdekja.

IX. Parashkrimi:

1. Nocioni;
2. Afati i parashkrimit;
3. Llojet e afateve;
4. Ndalja e parashkrimit;
5. Ndërprerja e parashkrimit.

X. Llojet e ndryshme të detyrimeve:

1. Detyrimi në para;
2. Detyrimi me disa objekte;
3. Detyrimet solidare;
4. Detyrimet e papjesëtueshme dhe të pjesëtueshme.

XI. Cedimi i kontratës:

1. Ndërrimi i debitorit ose i kreditorit;
2. Marrja përsipër e borxhit;
3. Hyrja në borxh.

Disa lloje të kontratave:

1. Kontrata e shitjes;
2. Rastet e shitjes me ujdi (favore) të posaçme (shitja me të drejtën e parablerjes, blerja në provë, shitja sipas mostrës ose modelit, shitja me specifikim, shitja me rezervimin e të drejtës së pronësisë së sendit të shitur;
3. Kontrata për dhurimin;
4. Urdhri i shitjes;
5. Kontrata e huas;
6. Kontrata për dorëzani;
7. Kontrata për veprën;
8. Kontrata për qira;
9. Huapërdorja;
10. Kontrata për veprën;
11. Kontrata për ortaki;
12. Kontrata për mbajtjen e përhjetshme.

E DREJTA SENDORE

I. Parimet themelore me të cilat karakterizohen të drejtat sendore:

1. Parimi i absolutitetit;
2. Parimi i numrit të përkufizuar të drejtave sendore;
3. Parimi i publicitetit;
4. Parimi i (specificitetit) caktueshmërisë së të drejtave sendore.

II. Sendet:

1. Kushtet që diçka të ketë kuptimin e sendit;
2. Ndarja e sendeve, me rëndësi për të drejtën civile;
3. Frutat.

III. Posedimi (Possesio):

1. Kuptimi dhe rëndësia e posedimit;
2. Objekti i posedimit;
3. Ndarjet e posedimit varësisht nga lloji (i ligjshëm dhe jo i ligjshëm; në mirëbesim dhe keqbesim; i drejtë dhe me të meta, posedimi i pavarur (autonom) dhe bashkë-posedimi; posedimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë);
4. Pozita juridike e poseduesit në mirëbesim dhe keqbesim;
5. Fitimi dhe humbja e posedimit;
6. Mbrojtja gjyqësore e posedimit;
7. Specifikat e procedurës në kontestet për pengim posedimi;
8. Masat e përkohshme në kontestet për pengim posedimi;
9. Vetëmbrojtja.

IV. Pronësia:

1. Kuptimi dhe përmbajtja e të drejtës së pronësisë;
2. Subjektet e të drejtës së pronësisë;
3. Të drejtat e tjera të pronarit të objektit banesor të ndërtuar në bazë të ligjit në pronën shoqërore;
4. Bashkëpronësia, prona e përbashkët dhe pronësia në etazhe;
5. Fitimi i të drejtës së pronësisë (sipas ligjit, me punë juridike, me trashëgim dhe me vendim të organit shtetëror);
6. Mënyra origjinere (okupimi, thesari, komasacioni, sipas lejes administrative, nga jopronari, parashkrimi fitues, krijimi i sendit të ri, konfiskimi, nacionalizimi shpronësimi, ndërtimi në tokë të huaj);
7. Mënyra derivative (baza juridike dhe mënyra e fitimit);
8. Llojet e padisë për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë (Actio reivindicatio, Actio publiciana dhe Actio negatoria);
9. Humbja e të drejtës së pronësisë.

V. E drejta e përparësisë së blerjes – kuptimi dhe rastet.

VI. E drejta e servitutit:

1. Servitutet personale (kuptimi, llojet dhe përkufizimi në kohë);
2. Servitutet reale - kuptimi dhe ndarjet e tyre varësisht nga përmbajtja dhe vëllimi;
3. Mënyra e fitimit të drejtës së servituteve (me punë juridike, sipas vendimit të organit shtetëror, në bazë të posedimit);
4. Humbja e të drejtës së servituteve;
5. Llojet e padisë nga praktika gjyqësore përkritazi fitimin, humbjen dhe vërtetimin e ekzistimit të së drejtës së servitutit.

VII. E drejta e pengut:

1. Objekti i pengut;
2. Llojet e pengut (standard, posedimor ose peng i blerjes);
3. Krijimi dhe vendosja e pengut;
4. Marrëveshja e pengut;
5. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me kolateralin;
6. Kur përfundon pengu,
7. Marrja e kolateralit nga pengmarrësi në rast mospërbushjeje nëpërmjet të gjykatës.

VIII. Hipoteka:

1. Objekti i hipotekës;
2. Kërkesat e siguruara me hipotekë;
3. Shuarja e hipotekës;
4. Ekzekutimi i kolateralit të hipotekës nëpërmjet të gjykatës (procedura

Burimet juridike:

Rreg. e UNMIK-ut nr. 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë;

Rreg. e UNMIK-ut nr. 1999/10 për shfuqizimin e legjislacionit diskriminues lidhur me kufizimin e qarkullimit të pasurisë së paluajtshme në Kosovë;

Rreg. e UNMIK-ut nr. 1999/25 dhe nr. 2000/59 për ligjin në fuqi në Kosovë;

Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, tetor 1978;

Ligji për detyrimet - Rreg. e UNMIK-ut nr. 2004/45, i miratuar në parim më 28.07.2004, i pashpallur, në procedurë për miratim;

Ligji për hipotekat – Rreg. e UNMIK-ut nr. 2002/21;

Ligji për pengun - Rreg. e UNMIK-ut 2001/5;

Ligji për themelimin e zyrës së regjistrimit të pengut – Rreg. e UNMIK-ut nr. 2001/32;

Ligji për krijimin e regjistrave për të drejtën e pronës, Rreg. e UNMIK-ut nr. 2002/22;

Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e afërta, Rreg. e UNMIK-ut nr. 2006/46;

Ligji për kadastër – Rreg. e UNMIK-ut nr. 2004/4, ndryshimet 2007/32;

Ligji për lojërat e fatit, Rreg. e UNMIK-ut nr. 2005/5;

Ligji për patentim – Rreg. e UNMIK-ut nr. 2004/56, ndryshimet 2007/10;
Ligji për transportin rrugor, Rreg. e UNMIK-ut nr. 2004/1, ndryshimet 2007/35;
Ligji për rrugët, Rreg. e UNMIK-ut nr. 2003/11, ndryshimet 02/L-121 i pashpallur.

E DREJTA FAMILJARE DHE TRASHEGIMORE

I. Afërsia gjinore:

1. Llojet e gjinisë;
2. Llogaritja e gjinisë.

II. Fejesa:

1. E drejta dhe përgjegjësia për dëmshpërblim për heqje dorë nga fejesa,
2. Fati i dhuratave të këmbyera në rast të prishjes së fejesës.

III. E drejta martesore:

1. Kushtet për lidhjen dhe vlefshmërinë e martesës;
2. Ndalesat dhe pengesat martesore;
3. Vendi dhe procedura e lidhjes së martesës zyrtare;
4. Kushtet për lidhjen e martesës religjioze dhe regjistrimi i saj;
5. Kushtet për lidhjen e martesës së shtetasve të huaj sipas LFK-së, dhe shtetasve kosovarë në botën e jashtme;
6. Mënyrat e shuarjes së martesës;
7. Martesat absolute nule;
8. Martesat relative nule;
9. E drejta në padi për anulimin e martesës;
10. Pasojat e anulimit të martesës;
11. Shkaqet e shkurorëzimit;
12. E drejta në padi për shkurorëzim;
13. Mundësia e vazhdimit të procedurës nga trashëgimtarët;
14. Shkurorëzimi me marrëveshje;
15. Pasojat e anulimit dhe shkurorëzimit të martesës, veçmas për ushqim;
16. Specifikat e procedurës në kontestet martesore;
17. Pasuria e veçantë e bashkëshortëve;
18. Pasuria e përbashkët, mënyra e disponimit dhe qeverisjes, si dhe ndarja e pasurisë së përbashkët.

IV. Bashkësia jashtëmartesore: Efektet juridike të bashkësisë jashtëmartesore

V. Marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve:

1. Prezumimet e atësisë martesore;
2. Kundërshtimi i atësisë martesore;
3. Kundërshtimi i atësisë jashtëmartesore;
4. E drejta prindërore, privimi dhe zgjatja e kujdesit prindëror.

VI. Adoptimi (birësimi):

1. Kushtet ligjore për adoptim përkitazi me adoptuesit dhe të adoptuarit;
2. Autoritetet kompetente për vendosje dhe procedura për adoptim;
3. Të drejtat dhe detyrimet mes adoptuesit dhe të adoptuarit;
4. Shuarja – anulimi i adoptimit dhe pasojat.

VII. Kujdestaria:

1. Llojet e kujdestarisë, varësisht nga subjektet nën kujdes dhe qëllimi i kujdesit, (kujdestaria ndaj personave të mitur, personave të rritur pa aftësi për të vepruar dhe kujdestaria për raste të veçanta).

VIII. Detyrimi ligjor për ushqim:

1. Mes bashkëshortëve;
2. Mes prindërve dhe fëmijëve;
3. Forma e ushqimit, varësisht nga personi që gëzon këtë të drejtë;
4. Caktimi i lartësisë së detyrimit për ushqim ligjor;
5. Kompetenca lëndore dhe vendore e gjykatave për vendosje lidhur me ushqimin.

IX. Marrëdhëniet pasurore të anëtarëve të bashkësisë familjare:

1. Administrimi i pasurisë (veçmas asaj të paluajtshme, regjistrimi në regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme);
2. Marrëveshjet kontraktuese mes anëtarëve lidhur me pasurinë e përbashkët.

X. Mbrojtja kundër dhunës në familje:

1. Dhuna në familje sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/12;
2. Masat mbrojtëse;
3. Llojet e urdhrave për mbrojtje nga dhuna në familje;
4. Organet kompetente për lëshimin e urdhrave;
5. Pasojat e shkeljes së urdhrave.

E DREJTA TRASHËGIMORE

Institutet e përgjithshme:

1. Trashëgimia, nocioni dhe prezumimet e trashëgimit;
2. Objekti i trashëgimit;
3. Fitimi i trashëgimit;
4. Koha dhe vendi i hapjes së trashëgimit;
5. Barazia në trashëgimi;
6. Marrëveshjet për trashëgiminë e ardhshme;
7. Zotësia për të trashëguar;
8. Bazat e thirrjes në trashëgimi;
9. Nocioni i trashëgimtarit;
10. Dallimi në mes të trashëgimtarit dhe suksesorit të vetëm;
11. Trashëgimia ligjore në përgjithësi;
12. Disponimet në rast vdekje.

Trashëgimia në bazë të ligjit:

1. **Rrethi i trashëgimtarëve**
2. Radhët e trashëgimisë;
3. Raporti në mes të radhëve të trashëgimisë;
4. E drejta e përfaqësimit;
5. E drejta e rritjes dhe e zvogëlimit të pjesës trashëgimore;
6. Pozita trashëgimtare e fëmijëve, trajtimi i barabartë i fëmijëve të trashëgimlënësit;
7. Shtimi i pjesës trashëgimore të fëmijëve;
8. E drejta e trashëgimit të adoptuarit dhe adoptuesit;
9. Të drejtat e bashkëshortit;
